

**AKTI I THEMELIMIT**  
**TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“FB Termosistemi” shpk**

Sot, në datë 28.03.2022, unë themeluesi, Florian Boka, atësia Haxhi, shtetas Shqiptar, me numër personal I20908062U, i datëlindjes 08.09.1982, lindur dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve të mëposhtëme.

**Neni 1**  
**Themelimi**

- 1) Emri i shoqërisë është “FB Termosistemi” shpk.
- 2) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2**  
**Objekti**

- 4) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në fushën e :
  - a) Ofrimin e punimeve dhe shërbimeve, në fushën e të impianteve teknologjike, sistemeve ngrohje dhe ftohje, paneleve diellore, impianteve të mbrojtjes nga zjarri, impiante gazi djegës, impianteve elektrike; përfshirë projektimin, instalimin dhe furnizimin e tyre.
  - b) Mirëmbajtjen e impianteve teknologjike, mekanike, eklektike; në të cilat përfshihen materialet/pajisjet e cituara me sipër si dhe të tjera në shërbim të tyre për përdorim civil, mjekësor, ushtarak apo industrial dhe shërbime e aktivitete të tjera të ngjashme.
  - c) Importin dhe eksportin e materialeve të ndryshme, impianteve, pajisjeve, veglave të punës, aksesoreve dhe materiale të tjera të ngjashme, që lidhen ngushtë me aktivitetin kryesor të shoqërisë.
- 5) Shoqëria, në të ardhmen, gjithashtu mund të zhvillojë çdo aktivitet tjetër të ligjshëm dhe që e gjykon të nevojshme.

**Neni 3**  
**Kohëzgjatja**

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4**  
**Selia**

- 1) Shoqëria e ka selinë në: Autostrada Durrës-Tiranë, Km. 3, Zona Kadastrale 3339, Nr. Pasurisë 290/146, ND-2, Vol. 14, Faqe. 122, Hyrja Qendrore, Vrrine, Rrashbull, Durrës.
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.



**Neni 5**  
**Kapitali themeltar**

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 120,000 (Një qind njëzet mijë) Lekë dhe është i ndarë në 1 (një) kuotë, që zotërohet plotësisht nga ortaku Florian Boka.
- 2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

**Neni 6**  
**Administratori**

- 1) Administrator i shoqërisë emërohet është Florian Boka, atësia Haxhi, shtetas Shqiptar, me numër personal I20908062U, i datëlindjes 08.09.1982, lindur dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar; me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.

**Neni 7**  
**Baza Ligjore**

- 1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 8**  
**Mosmarrëveshjet**

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

\*\*\*

**ORTAK I VETËM**  
**I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"FB Termosistemi" shpk**

*FLORIAN BOKA*  
Florian Boka  
(Emër, Mbiemër, Firma)

